

Për Mirëqenie Sociale dhe Mjedisore, Berat

1. Informacion Bazë

- Viti i Themelimit: 2000
- Statusi Ligjor: OJF
- Selia Qendrore: Berat, Shqipëri
- Faqja e Internetit: natyraberat.org
- Email kryesor i organizatës: mireqeniesociale@gmail.com
- Telefoni kryesor i organizatës: 0692878907

2. Misioni

Për Mirëqenie Sociale dhe Mjedisore (FSEW) ka si mision të saj mbrojtjen e mjedisit, realizimin e aktiviteteve për mbrojtjen e tij, energjisë së pastër, efikasitetit të energjisë, mbrojtjen e ekosistemit, promovimin e burimeve të rinovueshme me një angazhim të palëkundur ndaj sigurisë, cilësisë dhe vlerave krah partnerëve, bashkëpunëtorëve dhe publikut që na mbështet. Ne jemi të përkushtuar të hartojmë dhe menaxhojmë projekte që rrisin mirëqenien e komunitetit në lidhje me mjedisin, të llojmë për mbrojtjen e zonave të mbrojtura, rurale dhe komuniteteve të tyre.

3. Vizioni

Ne do të vijojmë të angazhohemi për të rritur dhe diversifikuar organizatën tonë me qëllim përmirësimin e vlerave mjedisore për një të ardhme më të mirë, më të gjelbër dhe më të qëndrueshme për komunitetin të cilit i shërbejmë me krenari.

4. Fushat Kryesore të Fokusit

- Mbrojtja e Mjedisit që na rrethon, për një cilësi jetese më të mirë të njerëzve.
- Zhvillimi i Komunitetit të zonave rurale për njohuri të thelluara mbi vlerat ekologjike që mbartin, me qëllim rritjen e ekonomive të tyre familjare.
- Zbutja e Ndryshimeve Klimatike, ku gjithsecili mund të shoh veten si superheroi i klimës.
- Advokimi institucional për përfshirjen e aktivistëve mjedisor në Politikë.
- Edukimi i të rinjve (metodologjia informale) mbi njohuri të thelluara mbi cilësinë e ujit, ajrit, aktivizmit mjedisor.
- Përfshirje në monitorime si “Vlerësimi i Transparencës dhe Llogaridhënies në Bashkinë Berat”.

5. Aktivitetet/Programet Kryesore

- Projekti/Programi 1: Edukimi mjedisor i të rinjve: Në Bashkëpunim me organizata të tjera të shoqërisë civile, me qëllim rritjen e aftësive edukuese mjedisore të të rinjve, me mbështetjen e donatorëve (UNICEF i fundit), është punuar për disa paketa edukimi. E para përmendim vitin 2023, kurse e dyta sapo ka nisur, Maj 2025. Qëllimi i projekteve është përfshirja e të rinjve në sesione informimi, edukimi, konferenca; marrja e përgjegjësisë në uebinare angazhimi i të rinjve që janë në forume rinore të Bashkisë Berat, për të sjellë risi dhe aktivitete mjedisore në Bashki. #youth4CleanAir.

Projekti: Politika të propozuara në fushën e energjisë së pastër:

- Shoqata “Për Mirëqenie Sociale dhe Mjedisore”, me mbështetjen e rrjetit të Vigjilencës mjedisore ku ajo bën pjesë, ka ndërmarrë një ndërhyrje që synonte: forcimin e rolit, përfshirjen dhe pozicionin e shoqërisë civile në mobilizimin e aktorëve lokalë, dhe rajonalë për rritjen e influencës qytetare dhe sjelljen e ndryshimit pozitiv në dobi të menaxhimit aktiv të varfërisë energjetike në vend. Ky program u realizua përgjatë vitit 2023, me mbështetjen e (smartbalkansproject.org), IDM Shqipëri. Përgjatë 7 muajve është punuar në Bashkitë: Berat dhe Tiranë, Shkodër, Elbasan, Vlorë, për politika mbështetëse në fushën e energjisë, përkrahjes sociale, për përballimin e pasojave të varfërisë energjetike dhe përhapjen e praktikave të efikasitetit energjetike tek shtresat vulnerabël.

- Projekti

Proçese monitoruese: “Vlerësimi i transparencës dhe llogaridhënies në Bashkinë Berat”

Për Mirëqënie Sociale dhe Mjedisore, Berat

Vlerësimi i transparencës proaktive të institucionit, përmes monitorimit të PT. Përmes këtij projekti monitorues është synuar përmirësimi i zbatimit të së drejtës së informimit, nëpërmjet monitorimit dhe kontributit që japin OSHC-të e aftësuar në zbatimin efektiv të ligjit. Gjetjet dhe rekomandimet e këtij monitorimi synuan të nxisnin më tej vullnetin dhe gatishmërinë e institucioneve të pushtetit vendor për të rritur transparencën përmes publikimit proaktiv të informacionit në PT. Procesi i monitorimit u zhvillua Gusht-Shtator 2020, duke përdorur instrumentin e Sistemit të Matjes së Transparencës dhe Llogaridhënies.

- Monitorim VNM- Fabrika e Lëkurave në Uznovë;
- Monitorim i mbetjeve spitalore;
- Monitorim i krimeve mjedisore (Tomorri) etj

6. Shtrirja Gjeografike

Shoqata është kombëtare, me Seli në Berat. Ajo ushtron aktivitete në Bashkinë Berat, Kuçovë, Urë Vajguore, Skrapar, por me bashkëpunimet në rrjete, e suportuar nga organizata partnere ka punuar edhe në Bashki si Shkodër, Vlorë, Tiranë, Elbasan.

7. Udhëheqja

Drejtori Ekzekutiv/CEO: Gentiana Decolli

Bordi i Drejtuesve: Edlira Reovica; Gentiana Decolli, Edita Tresa, Almir Duli, Admir Nake.

8. Partneritetet dhe Bashkëpunimet

Shoqata është pjesë e Rrjetit të Vigjilencës në Shqipëri; pjesë e ANRD, që mbështet zonat rurale në Shqipëri.

Ajo ka patur mjaft bashkëpunues ku ndër ta përmendim qendrën Aarhus, EDEN center, IDM Shqipëri, IRCA, LDA Albania, mjaft organizata locale në Berat etj

Donatorët kanë qënë të larmishëm, ku ndër të tjerë: REC Shqipëri, ambasada Suedeze në Tiranë, UNICEF Albania, AMSHC, Qendra EDEN, IDM Shqipëri, EU in Albania, EU Human, etj

9. Ndikimi

- Përgjatë projektit të vitit 2023 “Siguri energjetike nëpërmjet zbutjes së varfërisë energjetike në Bashkinë Berat”, u trajnuan në 5 Bashki të Shqipërisë 144 persona, kryesisht të rinj e të reja, nga trajnerë të ndryshëm. Po në kuadër të këtij projekti u ngrit një grup lobues QKE (Komiteti Qytetar i Energjisë), i cili luajti rol advokues, negocues, impaktues për nisma e kauza që vinin nga Shoqëria Civile.
- Është përdorur media lokale (television lokal) dhe media e shkruar në disa portale online, me shikueshmëri Kombëtare, për të rritur vizibilitetin e aktiviteteve tona, nismave dhe lajmërimeve në kuadër të projekteve të ndryshëm.
- Janë bërë publike problematika të nxehta si mbetje spitalore të hedhura buzë lumit Osum, mbetje industriale që vijnë nga industri e në Uznovë, dhe mbi këto konstatime të nxjerra nga puna e OJF janë ndikuar edhe politikat e grumbullimit të këtyre mbetjeve, apo ndryshime teknologjish të vjetra të industrive

Lajmet e Fundit/Çmimet

Green Berat, vendi i tretë- Çmim nga FLAG- Swiss Contact (Projekti i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta, Qarku Berat).